

## RAPORTI KRYETARIT - SHKUMBIN BISLIMI – 2015

Të nderuar anëtar/e të shoqatës, të nderuar të pranishëm

Para një viti në kuvendin e kaluar të shoqatës mora besimin tuaj për ta udhëhequr shoqatën 17shkurti.ch si Kryetar i saj. Falenderoj gjithë anëtarët e shoqatës, të cilet paguan anëtarësinë për vitin 2015, në këtë vit kanë paguar mbi 190 anëtar.

Një falenderim i veçant është për sponsorin gjeneral „Swiss Versicherungen“.

Gjithashtu dëshiroj ti falenderoj sponsorët tanë pothuaj të rregullt:

- Arsat GmbH
- Mode Boutique USA
- Fehmia Reisen
- Klubi Iliria
- Allenmoos Garage GmbH
- Dr. med. Sefer Gashi
- Goni Coiffeur
- Maliqi Automobile GmbH



Gjithëashtu i falenderoj edhe sponsorët lokal për përkrahjen e tyre, ku pa ndihmën e tyre nuk do të kishim mundësi ti realizonim gjithë këto projekte.

Shoqata 17shkurti.ch edhe këtë vitë realizoi shumë projekte:

- Mirëmbajtja e lumit & varrezave - Punëtori Amir Murati
- Mirëmbajtja e mashinerisë për mirëmbajtje të lumit dhe varrezave
- Mirëmbajtja e fshatit - Punëtori Isa Foniqi
- Mbjedhja e luleve nëpër fshat
- Inventari fshatit - 70 Flamuj për festën e Pavarësisë
- Infrastruktura e shoqatës: Blerja e zërimit për kuvend, objektiv i aparatit, webfaqja
- Blerja e antenës për Livecam & Interneti për kamerë
- Java Kulturore
- Rregullimi i hekrave - Rrethoja e fushës së shkollës
- Pagesa e rrymës për fushën e sportit nga javët kulturore 2013/14/15- te shkolla
- Iftarë publik
- Aksioni ta shpëtojmë një jetë - për Nerxhivane Kastrati
- Ndihmë financiare "për të pame" pas vdekjes së Nerxhivane Kastrati
- Kurorë & ndihmë financiare "për të pame" për ish puntorin e shoqatës Nexhat Kastrati
- Ndihma familjeve skamnore
- Rregullimi i hyrjes së parkut
- Rregullimi i bankave të parkut
- Camp-Shtëpiza te Urime Pavarësia
- Shtëpiza për zogjë të natyrës - 9 copë
- Rregullimi i kupollës
- Ndërtimi komplet i një shtëpie për një familje të varfër në fshatin Dobërcan
- Participim nga shoqata për ndërtimin e një shtëpie për një familje të varfër

Një ndër projektet më të kushtuara ishte edhe ai i ndërtimit të një shtëpie, ku pritet që ditëve të ardhshme të përfundoj. Për realizimin e këtij projekti falenderoj gjithë kontribuesit e këtij projekti. Në veçanti dua ti falenderoj Klubin Iliria ku gjindemi tash, Arsat GmbH (Digitalb.ch) dhe Maliqi Automobile GmbH, këto firma dhe klube kontribuan veçanërisht shumë. Duhet ta përmendi edhe Vaxhid Bislimin, i cili na dhuroj dyerë dhe dritaret për këtë shtëpi. Vaxhidi e financoi edhe transportin e tyre, faleminderit për këtë gjest human.

Gjatë vitit 2015 nuk kena mbajtur shumë mbledhje të kryesisë, përiferisht 6-7 mbledhje. Faleminderit anëtarëve të kryesisë, për përkrahjen e tyre gjatë vitit 2015.

Shpresoj që shoqata edhe në të ardhmën të vazhdoj me këtë ritëm.

Me respekt - Shkumbin Bislimi